



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË PRAKTIKE E GJUHËS B (1)

Ngarkesa: 8 kredite; 80 orë mësimore; 0 leksione / 80 seminare
Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I/ Semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në gjuhë, letërsi dhe qytetërim grek
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon t'i bëjë studentët të aftë për të përvetsuar sa më mirë gjuhën e folur dhe të shkruar greke. Ata duhet të jenë në gjendje të fusin në fjali fjalë dhe struktura të reja gramatikore. Shprehia e të folurit realizohet nëpërmjet përshkrimit të figurave në fillim të njësive, duke nxitur mendimin e pavarur të studentëve.

Objektivat specifike lëndore: Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore dhe strukturat gjuhësore të gjuhës greke, të tilla si procesi i formimit të fjalëve të reja dhe i atyre ekzistuese; pjesët e ligjëratës dhe tipat e ndryshëm të fjalëve, bashkë me nën-kategorizimin e tyre; sistemin emëror dhe foljor etj. Në fund të këtij kursi studenti do të jetë i aftë të analizojë pjesët përbërëse në nivel të fjalës; të kategorizojë fjalët varësisht nga struktura dhe mënyra e formimit të tyre; të dallojë konceptet themelore të analizës gramatikore në përgjithësi dhe të analizës së fjalës në veçanti; të realizojë analizë morfologjike të fjalës; të kategorizojë fjalët varësisht nga përfshirja e tyre në një tip të caktuar fjalësh, duke u mbështetur në formën dhe në kuptimin e tyre